

Rektori
Prof.Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 47/20; Datë: 09.01.2020

Në bazë të nenit 49 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për studime themelore-bachelor në UShAF.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.


A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe rregullimit të të drejtave dhe përgjegjësi të studentëve gjatë studimeve themelore-bachelor në UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



Në bazë të nenit 49 pika 1.3. të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF), Senati i USHAF-it, në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020, miraton:

RREGULLORE PËR STUDIME THEMELORE (BACHELOR)

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me Rregullore për studimet themelore – bachelor (në tekstin e mëtejshëm: “Rregullore”) në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: “Universiteti”), përcaktohen dhe rregullohen çështjet:

- Pranimi në studime;
- Programet e studimeve;
- Përcaktimi i suksesit akademik;
- Punimi i diplomës;
- Njohja e studimeve;
- Viti akademik;
- Gjuha e studimeve;
- Studentët, të drejtat dhe përgjegjësitë;
- Organizimi i studentëve;
- Përgjegjësia disiplinore;
- Dispozitat kalimtare;



II. Pranimi në studime

Neni 2

Numri i vendeve për studime bachelor përcaktohet nga Senati me propozim të Këshillit Mësimor/Shkencorë (në tekstin e mëtejshëm: "Këshilli"). Vendimi bazohet në arsyeshmërinë e mundësive infrastrukturore e kadrovike dhe nevojave të tregut.

Neni 3

1. Të gjithë kandidatët që kalojnë testin e maturës, gëzojnë të drejtën për të konkurruar për studime në Universitet.
2. Në Universitet mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollën e mesme, pa maturë, të vërtetuar me diplomë përkatëse, por që i nënshtrohen provimit pranues.
3. Kushtet për pranim në studimet themelore-bachelor:
 - 3.1. Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë, i vërtetuar me diplomë;
 - 3.2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit të vërtetuar me diplomës përkatëse;
 - 3.3. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit të vërtetuar me diplomë përkatëse në botën e jashtme, në qoftë se është bërë baras vlerësimi me diplomën e maturës nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 3.4. Për fusha të veçanta studimi Universiteti organizon provime shtesë-provim pranues për disa lëndë, në procedurën e pranimi të studentëve, të cilat pranohen nga Ministria. Studenti duhet të kalojë me sukses provimin pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve.
4. Kriteret për vlerësim, rangim dhe pranim, caktohen nga Ministria dhe Senati i Universitetit.

Neni 4

Kandidatët jo të pranuar në studime kanë të drejtë ushtrimi të ankesës në Universitet më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në kuadër të Universitetit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm i kandidatëve për konkurrim:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Dëftesat e shkollës së mesme;
- Vërtetimi për lëndët e vlerësuara me pikë në testin e maturës;



- Certifikata e lindjes;
- Letërnjoftimi (kopje).
- Pagesa për aplikim, shuma e së cilës përcaktohet nga Ministria.

Neni 6

Kandidatët e pranuar në Universitet me rastin e regjistrimit, duhet të ofrojnë:

- 2 (dy)fotografi të formatit 4.5. x 6 cm;
- Fletëregjistrim i cili me rastin e regjistrimit merret në Universitet;
- Fletëpagesa për regjistrim të semestrit (shuma e së cilës) caktohet nga Ministria.

III. Programet e studimeve

Neni 7

Studimet në Universitet mbahen sipas programeve të studimeve, të përgatitura nga Këshilli dhe të miratuara nga Senati.

Neni 8

1. Universiteti ofron studime themelore – bachelor të nivelit të I-rë sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimit, me tri vite, gjashte semestra , në të cilët studenti tubon së paku 180 kredi të ECTS.
2. Universiteti organizon vetëm studime të rregullta. Studimet në Universitet janë të përqendruara në programet akademike:
 - Menaxhment Industrial (Bachelor Shkencor)
 - Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë (Bachelor Shkencor)
 - Inxhinieri Industriale me Informatikë (Bachelor Shkencor)
 - Arkitekturë të Interierit dhe Dizajni i mobileve (Bachelor Shkencor)
 - Dizajni dhe Konstruksionet e produkteve nga Druri, (Bachelor Profesional)
 - Dizajni Grafik dhe Multimedia (Bachelor Profesional).
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve bachelor, fitohet thirrja akademike bachelor i shkencës, varësisht prej departamentit dhe profilit përkatës të kryer.

Neni 9

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve bachelor, studenti kualifikohet për fushën:

1. Menaxhmenti industrial:

- Aplikimi i njohurive të koncepteve , teorike dhe disiplinat që mbështesin menaxhimin e teknologjisë industriale
- Demonstrimi i aftësive të të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve komplekse industriale të menaxhimit të teknologjisë
- Shprehjen e rrjedhshme të ideve komplekse dhe të sofistikuara duke përdorur një gamë të formateve dhe medieve
- Kryerja e aktiviteteve me aftësi të mira shoqërore dhe udhëheqëse si dhe demonstrimi një gjendje të përgjegjësisë
- Fitimi i aftësive drejtuese dhe ekipore dhe aftësia për të bashkërenduar detyrat dhe programet përkatëse

2. Menaxhment i Turizmit dhe Ambientit (hotelerisë)

- Studimi dhe përfitimi i njohurive themelore për menaxhim cilësor në Turizëm dhe Hoteleri.
- Mundësi punësimi në bizneset e hotelerisë, sidomos menaxhimin e bizneseve
- Punësim në agjencitë e udhëtimit dhe turizmit
- Përgatitja e projekteve lidhur me lëminë e turizmit dhe hotelerisë.

3. Inxhinieri industriale me Informatikë

- Kuptimin e koncepteve themelore të inxhinierisë mekanike
- Njohjen e llojeve të materialeve artificiale dhe teknologjinë e përpunimit të tyre
- Zhvillimi i aftësive praktike për punimin e materialeve të ndryshme në veçanti atyre plastike
- Zotërimin dhe aplikimin e njohurive teorike dhe praktike në hartimin e një punimi/projekti kërkimor (punimi i diplomës)

4. Arkitekturë të Interierit dhe Dizajni i mobileve

- Studimi dhe përfitimi i njohurive themelore për materialet me bazë prej druri dhe vetitë e tyre, metodat, teknikat dhe teknologjitë e përpunimit, kontrolli i cilësisë në përgjithësi,
- Projektimi, konstruktimi, rikonstruimi dhe zbatimi praktik i projekteve në procesin prodhues dhe montues në interier dhe eksterier,
- Mobilimi i objekteve publike e individuale duke u shërbyer me projektet vetanake apo klientët potencial,



- Punë në studio projektuese dhe në ndërmarrjet prodhuese ku në mënyrë aplikative implementohen dhe realizohen projektimet e mobileve dhe dizajnit të interiorit,
- Angazhimi në ndërmarrjet për prodhimin e mobileve , prodhimin e produkteve të industrisë së drurit, prodhime speciale dhe fisnikërimin e materialeve me baza druri në përgjithësi.

5. Dizajni dhe Konstruksionet e produkteve nga Druri, (Bachelor Profesional)

- Të dijnë të bëjnë skicimin e produktit,
- Kuptojnë përmbajtjen e Dizajnit dhe Konstruksionet e Produkteve nga druri,
- Demonstrojnë aftësitë e të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve komplekse të Interiorit dhe konstruksioneve të drurit
- Implementojnë aftësitë teknike të cilat duhet të ndërmerren për prodhimin produkteve
- Dizajnimit dhe zgjidhjeve konstruktive e produktit që do të prodhohet,
- Praktikojnë aftësi efektive të komunikimit me punëtorët e ndërmarrjes,
- Të dijnë të llogarisin çmimin e produktit të prodhuara dhe të dijë të menaxhoj prodhimin e produkteve.

6. Dizajni Grafik dhe Multimedia (Bachelor Profesional)

- Analizojnë probleme të ndryshme profesionale artistike;
- Aplikojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në lëmit e ndryshme në realizimin e aktiviteteve në fushën e dizajnit grafik;
- Kontribuojnë në mënyrat e reja të menduarit dhe proceseve inovative;
- Punojnë në mënyrë individuale dhe grupe në problemet teorike dhe praktike (duke gjetur dhe aplikuar metodat adekuate të hulumtimi shkencor);
- Kuptojnë kompleksitetin e procesit të operacioneve të shtypit grafik dhe shërbimeve dizajnuese dhe anasjelltas;
- Shfrytëzojnë programet moderne kompjuterike (Corel Draw, Adobe Photoshop, Adobe Indesign, Adobe Flash, Adobe Illustrator, Adobe Dreamweaver, Open source web (wordpress) etj) në dizajnin dhe ofrimin e shërbimeve të dizajnit grafik dhe shtypit.
- Planifikojnë, inicojnë dhe ekzekutojnë projekte të ndryshme në fushën e dizajnit Grafik dhe multimedia (audio, video);
- Menaxhoj mbrojtjen dhe sigurinë në punë si dhe ruajtjen e ambientit.

[Signature]

Neni 10

Për programet dy lëndore të studimeve, ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, Universiteti në rast nevojë do të veproj në përputhje të dispozitave të Statutit dhe dispozitave juridike në fuqi.

Neni 11

Angazhimi i personelit mësimor. Të drejtën e dhënies së mësimit në studimet themelore e kanë: Profesorët e rregullt, Profesorët e asocuar dhe Profesorët asistent, Ligjeruesit dhe Lektorët. Në mësimdhënie, si bartës i lëndëve, angazhohet vetëm personeli akademik me thirrjen akademike të Profesorit të rregullt, Profesorit të asocuar dhe Profesorit asistent, e në raste të veçanta edhe personeli me magjistraturë (Mr. Sc.) apo Master (MSc.) nën mbikëqyrjen e profesorëve me grada akademike të Profesor Asistentit e më shumë, me propozim të Këshillit dhe leje të Rektorit.

IV. Përcaktimi i suksesit akademik

Neni 12

Për përcaktimin e suksesit akademik aplikohen këto metoda:

1. Provimi
2. Kolokviumi
3. Punimi seminarik
4. Praktika profesionale
5. Testi praktik gjatë ushtrimeve

Neni 13

Në Fakultet zbatohen këto nota për përshkrim të suksesit në provime:

- 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)
- 8 (shumë mirë)
- 7 (mirë)
- 6 (mjaftueshëm)
- 5 (pamjaftueshëm)

Neni 14

1. Provimet paraqesin mënyrë të rregullt të vlerësimit të dijes së studentit.



2. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë sipas programit të studimeve (provim me komision).
3. Provimet mbahen në lokalet e Universitetit. Ato mbahen :
 - 3.1. Me shkrim;
 - 3.2. Me gojë ;
 - 3.3. Me shkrim dhe me gojë;
 - 3.4. Praktike.
4. Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim mbahen brenda 7 ditëve.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës, ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
 - 6.1. Studenti është ankuar
 - 6.2. Është caktuar me programin e studimeve
7. Procedura e mbajtjes së provimeve është e përcaktuar me programin e studimeve, ndërsa mënyra e vlerësimit të dijes së studentit në provim përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

Neni 15

1. Provimet në Fakultet mbahen gjatë afateve të provimeve.
2. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).
3. Periudha e saktë për çdo afat përcaktohet me kalendar të përgjithshëm të studimeve.
4. Data e fillimit dhe përfundimit për çdo afat të provimeve propozohet nga Këshilli dhe miratohet nga Senati.
5. Oraret provimeve shpallen në fillim të vitit akademik për tërë vitin akademik.
6. Oraret e provimeve përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.
7. Oraret e provimeve të shpallura janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

Neni 16

1. Paraqitja e provimeve fillon jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të mbajtjes së afatit të provimit.
2. Orari i provimit shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së mbajtjes së provimit.
3. Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet i dështuar dhe shënohet me notë 5.



4. Me kërkesë të tij, studentit mund t'i lejohet, nga Këshilli që të hyjë më herët në provim po qe se merrë pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

Neni 17

1. Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë me shkrim dekanit të Fakultetit kundër notës së marrë. Ankesa parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.
2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:
 - 2.1. Për provimin me shkrim- parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
 - 2.2. Për provimin me gojë – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
 - 2.3. Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:
 - 2.3.1. Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë;
 - 2.3.2. Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.
3. Pas pranimi me kohë të ankesës, dekani formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.
4. Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
5. Në rast të ankesës kundër notës në provim me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
6. Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.
7. Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentit ruhen maksimalisht 30 ditë.

Neni 18

1. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.
2. Studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
3. Studenti pasi të ankohet , me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të emëruar nga dekani.



4. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.
5. Në rast se studenti sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, humb statusin studentit për këtë lloj të studimeve.
6. Studenti mund të ri fitojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi i Këshillit përcakton provimet dhe çështjet të tjera që i pranohen studentit dhe obligimet e studentit në programin e ri të studimeve.

Neni 19

1. Pas përfundimit të semestrit të fundit të studimeve bachelor, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
2. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.

V. Punimi i diplomës

Neni 20

1. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me dhënien e provimit të fundit. Përjashtim bëjnë programet e studimit të cilat në kurrikulat e tyre kanë paraparë punimin e diplomës bachelor, me provim para komisionit, me të cilin përfundojnë studimet e tyre.
2. Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës nga dy ose tre studentë vendoset nga Këshilli.

Neni 21

Punimi i diplomës vlerësohet me notë prej 6 deri në 10 dhe tërheqë kredi të caktuara ECTS sipas programit mësimor.



Neni 22

1. Zyrtarizimi i punimit të diplomës bëhet me kërkesë të studentit, e nënshkruar nga mentori. Zyrtarizimi (miratimi) i punimit të diplomës mund të bëhet vetëm atëherë kur studenti ka minus një provim të pa dhënë dhe verifikimit nga shërbimi përkatës i Universitetit për provimet e dhëna.
2. Pas miratimit të temës së punimit të diplomës nga Këshilli, caktohet komisioni vlerësues nga lëmia përkatëse prej tre anëtarëve të rregullt (mentorit dhe dy anëtarëve të tjerë nga stafi akademik) dhe një anëtar rezervë.

Neni 23

1. Tema e punimit të diplomës nuk mund të mbrohet 30 ditë pa kaluar koha nga data e miratimit të saj.
2. Tema e punimit të diplomës duhet të dorëzohet te komisioni vlerësues në 5 kopje identike, 7 ditë para mbrojtjes së saj.

Neni 24

1. Tema e punimit të diplomës duhet të mbrohet brenda 1 viti prej ditës së miratimit të saj.
2. Në rast se punimi i diplomës nuk mbrohet në afatin e paraparë, me kërkesë të justifikuar të studentit, dekani, mund të vazhdojë afatin edhe për 1 vit tjetër. Nëse kandidati edhe në afatin e zgjatur nuk mbron punimin e diplomës, caktohet temë e re e punimit të diplomës.
3. Në rast të vlerësimit negativ të mbrojtjes së punimit të diplomës, procedura e mbrojtjes mund të përsëritet pas 30 dite nga dita e vlerësimit negativ.
4. Nëse kandidati edhe pas tentimit të dytë nuk mbronë punimin e diplomës humbë të drejtën e mbrojtjes në temën e dhënë dhe duhet filluar procedurën për marrje të punimit tjetër të diplomës.

Neni 25

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe mbrojtja e saj bëhet në lokalet e Universitetit. Gjatë mbrojtjes së punimit të diplomës mbahet procesverbal. Nota e marrë gjatë vlerësimit shënohet në procesverbal dhe fletëparaqitje të studentit.

Neni 26

Pas mbrojtjes së suksesshme të punimit të diplomës, studenti përfundon studimet dhe fiton titullin akademik bachelor varësisht prej programit të studimeve. Studenti i diplomuar pajiset me certifikatë të notave, diplomë suplementare dhe diplomë për studimet e kryera.



Neni 27

Pas mbrojtjes së punimit të diplomës, Komisioni pyetës tërhiqet për një kohë të shkurtër për vlerësim dhe më pas bënë komunikimin e rezultatit të mbrojtjes së temës.

Komisioni bënë vlerësimin me nota prej 6 -10, plotëson procesin dhe tërë materialin e dërgon në administratë për procedim të mëtejshëm.

VI. Njohja e studimeve

Neni 28

1. Në pajtim me rregullat e Konventës së Lisbonës mbi njohjen dhe në pajtim me Udhëzimet administrative të MASHT, si dhe dispozitat e Statutit të UShAF-it, Universiteti pranon kualifikimet (titujt, diplomat, provimet) e institucioneve të njohura a të licencuara vendore ose të huaja të arsimit të lartë.
2. Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it mbi parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, është kompetencë e Universitetit që të bëjë njohjen e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare dhe të certifikatave të periudhave të caktuara të studimeve, me qëllim të vazhdimit të studimeve.
3. Në rastin e pranimit të kualifikimit , studenti ka të drejtë të vazhdojë studimet në Universitet.

Neni 29

Procedura e njohjes do të zhvillohet në Universitet. Vendimi për njohjen e studimeve bazohet në informatat e nxjerra nga baza e të dhënave përkatëse Europiane dhe koordinohet me Këshillin Kombëtar për Njohje, i cili është përgjegjës për aplikimin e Konventës së Lisbonës për Njohje. Në raste të tjera vendoset sipas dispozitave të Statutit të Universitetit.

VII. Viti akademik

Neni 30

1. Në përputhje me Statutin e tij, Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjatë 12 muaj. Viti akademik fillon me 1 tetor dhe mbaron me 30 shtator.
2. Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokviumet) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror fillon me 1 tetor dhe mbaron me 15 janar. Semestri veror fillon me 16 shkurt dhe mbaron me 31 maj.



3. Lënda mund të ligjërohet 15 javë në një apo dy semestra, apo si bllok ligjëratash në një semestër.
4. Orari i ligjëratave nxirret në fillim të vitit akademik dhe pas publikimit të tij është i obligueshëm për mësimdhënës dhe studentin.
5. Ngarkesa vjetore e studentit me ligjëratë, ushtrime, përgatitje dhe të tjera është 750 orë në semestër, respektivisht 1500 orë në vit, që korrespondon me 30 kredi në semestër apo 60 kredi në vit. Çdo ECTS kredi është e barabartë me 25 orë angazhim të studentit.

VIII. Gjuha e studimeve

Neni 31

1. Në Universitet, studimet organizohen në gjuhën shqipe.
2. Me propozim të Këshillit, Senati mund të vendosë për programet e studimit në gjuhë tjera në raste të argumentuara dhe nevojës (promovimi i këmbimit akademik), situata në tregun e punës, interesi i studentëve, orientimi akademik i mësimdhënësve) që favorizojnë zhvillimin akademik të Universitetit.

IX. Studentët – statusi, të drejtat dhe përgjegjësitë

Neni 32

1. Personi i regjistruar në Universitet e ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit vërtetohet me librezën e studentit (kartë e studentit).
3. Forma dhe përmbajtja e kartelës së studentit përcaktohet me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Senati.

Neni 33

Studentët e pranuar në Universitet kanë të drejtë të:

1. marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
2. shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë;
3. marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet e universitetit;
4. marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Këshillit, Senatit dhe struktura të tjera ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe mënyrë të sqartë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve të lartshënuara;



5. paraqesin ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga Universiteti;
6. ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e Universitetit.
7. kundërshtuar një vendim apo një veprim të Universitetit ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.

Neni 34

Studentët që janë pranuar në Universitet kanë obligim:

1. T'i respektojnë rregulloret e Universitetit;
2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve;
3. T'i kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
4. Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
5. Të sillen mire në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin;
6. Të respektojnë rregullat e kodit etik të studentit;
7. Të paguajnë pagesat dhe tarifatat që janë të caktuara.

Neni 35

1. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studenti të regjistrohet në vitin tjetër.
2. Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.
3. Numri maksimal i viteve të regjistruara sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës.

Neni 36

1. Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:
 - 1.1. Kur vendos të largohet nga studimet;
 - 1.2. Kur i ka përfunduar studimet;
 - 1.3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
 - 1.4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
 - 1.5. Kur arrin numrin maksimal të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;



- 1.6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.
2. Studenti mund të kërkojë një herë t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr Këshilli. Në rast se merret vendim pozitiv studentin do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.
3. Këshilli zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:
 - 3.1. Për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart;
 - 3.2. Për individët me aftësi të kufizuar fizike, duke përfshirë edhe aftësitë e kufizuara të të pamurit dhe të dëgjuarit, apo mendore, vërtetuar me certifikatë të mjekut.
4. Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga Këshilli.
5. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet dëshmuara si të:
 - 5.1. Sëmundjes së rëndë;
 - 5.2. Kujdesi për fëmijën nën moshën tri vjeçare;
 - 5.3. Shtatzënisë dhe lehonisë;
6. Rastet tjera të justifikuara. Vendimi merret nga Këshilli.

Neni 37

Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studentin duhet të japë provimin diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.

Neni 38

1. Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
2. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, Këshilli vendosë për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë.
3. Në rast se studentin të regjistruar në vitin e parë të studimeve i lejohet suspendimi i përkohshëm dhe në ndërkohë planprogrami valid i kohës së regjistrimit nuk zhvillohet në vitin vijues, studentin duhet të vazhdoi studimet me planprograme të reja aktuale.



4. Kërkesa për suspendim të përkohshëm bëhet në fillim të vitit akademik.

X. Organizimi i studentëve

Neni 39

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'iu përkasin të gjithë studentët.
2. Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregullore të përgjithshme të nxjerra nga Këshilli Drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.

Neni 40

Interesat e studentëve përfaqësohen në Parlamentin e studentëve në nivel të Universitetit.

Neni 41

1. Anëtarët për Parlament të studentëve zgjidhen në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet studentore.
2. Propozimet për anëtarë të Parlamentit bëhen në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
3. Nominimi, mandati, numri i anëtarëve Parlamentit të Studentëve si dhe zgjedhja e tyre, përcaktohen me Statut si dhe Rregulloren mbi punën e Parlamentit të Studentëve.

XI. Përgjegjësia disiplinore

Neni 42

1. Këshilli i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat.
2. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon Këshillin.
3. Studentët e ndëshkuar me masë disiplinore kanë të drejtë t'i ankohen Komisionit të ankesave si organ i shkallës së dytë.
4. Për çështje të tjera do të veprohet konform Rregullores për përgjegjësinë disiplinore për studentë të nxjerrë nga Këshilli Drejtues.



XII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 43

Për çështjet të cilat nuk janë përfshi me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të Universitetit.

Neni 44

Studentët të cilët nuk i kanë kryer studimet në periudhën e paraparë, mund t'i vazhdojnë studimet sipas rregullave të studimeve të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 45

Kjo rregullore hynë në fuqi që nga dita e miratimit në Senat.

Neni 46

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për studime bachelor nr. 505/16, dt. 22.09.2016.

Neni 47

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

Rektori

Prof. Dr. Agron Bajraktari

